



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/60
Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 59 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/60

Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 40 Ligjit 03/L-071 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, me propozim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. I jepet mbështetje Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të nxjerr vendim shpjegues për të qartësuar obligimet e Tatimit në Vlerën e Shtuar të Korporatës Energjetike të Kosovës lidhur me importet e energjisë elektrike dhe furnizimin vendor të energjisë elektrike, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vendimi shpjegues i propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhur me Korporatën Energjetike të Kosovës miratohet me qëllim që të lehtësohet privatizimi i Korporatës Energjetike të Kosovës dhe nuk ka asnjë zbatim jashtë këtij qëllimi. Termet dhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim nuk do të konsiderohen precedent dhe nuk do të citohen si bazë për trajtime të ngjashme nga çfarëdo palë tjetër, përveç palës për të cilën është miratuar vendimi.
3. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeminister i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

Vendim Shpjegues Publik Nr.

Detyrimet e Tatimit në Vlerën e Shtuar për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK)

Ky vendim shpjegues publik është lëshuar në përputhje me Nenin 61.5 të Ligjit mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore, i cili i jep Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave autorizim të lëshojë vendime shpjeguese publike të nevojshme për implementimin e Tatimit në Vlerën e Shtuar (TVSh) që lidhen me mallrat dhe shërbimet, përderisa këto vendime shpjeguese publike miratohen nga Qeveria.

Ky vendim shpjegues publik është lëshuar për të qartësuar obligimet e TVSh-së së Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A. (KEK) për importet e energjisë elektrike dhe furnizimin vendor të energjisë elektrike.

Neni 1

Është shënuar se:

- i. Në pajtim me Nenin 8.1 të Ligjit Nr. 03/L114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, KEK është i obliguar të paguajë TVSh-në në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) bazuar në konsideratën totale të pagueshme për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga ai për konsumatorët e vet;
- ii. Në pajtim me Nenin 8.2 të Ligjit Nr. 03/L114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, vlera e tatueshme e një importi është vlera doganore e importit plus detyrimet doganore, akciza apo tatimet dhe pagesat tjera të aplikueshme, duke përjashtuar tatimin në vlerën e shtuar.
- iii. Në pajtim me Nenin 16.2 të Ligjit Nr. 03/L-114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, kur furnizimi i tatueshëm është i vazhdueshëm, detyrimi i TVSh-së lind secilën kohë që një faturë tatimore lëshohet, apo në kohën e pagesës nëse pagesa është bërë para lëshimit të një fature tatimore.
- iv. Në pajtim me Nenin 16.4 të Ligjit Nr. 03/L-114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, për importet, detyrimi i TVSh-së lind në kohën e përshkruar në përputhje me dispozitat e aplikueshme të Doganave, në kohën e importimit.

Duke marrë parasysh:

- Se Qeveria dëshiron të ec përpara në privatizimin e KEK-ut, i cili është ndërmarrje me pronësi publike dhe gjendja tatimore e KEK-ut duhet të definohet mirë për shkak të investitorëve të mundshëm;
- Se, në të kaluarën KEK-u gjithnjë ka shlyer detyrimin e vetë të përgjithshme të TVSh-së përmes deklaratave mujore të TVSh-së të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës;

- Se Administrata Tatimore dhe KEK-u kanë bashkëpunuar nga afër në përcaktimin e detyrimit tatimor të KEK-ut për të gjitha vitet deri më 2008 dhe kanë barazuar shënimet e KEK-ut dhe ATK-së;
- Se, ndonëse pranohet se KEK është dashur të paguajë TVSh-në në importet e energjisë elektrike, KEK nuk e ka bërë në mënyrë historike, dhe nuk ka qenë i obliguar ta bëjë atë për arsye të MiM në mes të AKM, MEF dhe ATK;
- Se detyrimi retroaktiv i TVSh-së në importe do të kërkojë rregullime të shumta në deklaratat e TVSh-së të dorëzuara në administratën tatimore nga KEK-u duke rezultuar në një punë të stërzgjatur për të rregulluar shënimet e ATK-së dhe KEK-ut për të dëmtuar punën e privatizimit;
- Se rezultati përfundimtar për buxhetin e Kosovës, pasi të gjitha rregullimet të jenë bërë, nuk do të ketë rritje në të hyra për shkak të detyrimit të TVSh-së në kufi do të rezultojë vetëm në rritjen e kreditimit të TVSh-së për KEK-un në deklaratë e tij mujore të TVSh-së të dorëzuar në ATK, dhe
- Se KEK-u ka përmbushur në tërësi dispozitat e MiM në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe KEK-ut që ka vënë përpara mënyrën me të cilën KEK-u është dashur të rregullojë detyrimin e TVSh-së, i cili MiM është vazhdim i MiM që më herët ka qenë në fuqi në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, dhe Administratës Tatimore.

Neni 2

Pavarësisht dispozitave të Nenit 16.4 të Ligjit Nr. 03/L-114, KEK-u nuk do të ketë detyrim të paguajë TVSh-në për importet e energjisë elektrike, por tërësisht të shlyej detyrimin e vet për TVSh përmes deklaratës mujore të TVSh-së që dorëzohet në ATK.

Neni 3

3.1 Pavarësisht dispozitave të Nenit 8.1 dhe 16.2, KEK do të vazhdojë të dorëzojë deklaratën e TVSh-së bazuar në shumat e faturuara për konsumatorët e vet. KEK do të vazhdojë të paguajë TVSh-në bazuar në TVSh-në që në të vërtetë ka mbledhur përmes periudhës së tatueshme të përfunduar më 30 Qershor 2009.

3.2 Për periudhat e tatueshme të përfunduara pas 1 Korrikut 2009, KEK do të vazhdojë të dorëzojë deklaratat e TVSh-së bazuar në shumat e faturuara për konsumatorët e vet dhe do të kërkojë të paguajë atë shumë të TVSh-së me deklaratën e tyre pa marrë parasysh se a është inkasuar (mbledhur) apo jo.

3.3 KEK do të implementojë dispozitat e borxhit të keq duke filluar me deklaratën e TVSh-së për periudhën tatimore duke filluar më 1 Korrik 2009 si mënyrë për të ulur obligimin e vet të TVSh-së për atë periudhë dhe ato pasuese. Kur i referohemi 'borxheve të këqija' në kontekst të vendimit shpjegues publik, pranohet se procedurat e përshkruara i referohen vetëm përcaktimit të borxhit të keq për qëllime të administratës tatimore dhe në asnjë mënyrë nuk konkludon (dëshmon) se KEK ka humbur mundësinë për të marrë ndonjë apo të gjitha masat juridike që së fundi të detyrojë mbledhjen e borxhit.

3.4 Për qëllime të këtij vendimi shpjegues, konsumatorët e KEK-ut për të cilët duhet të lëshohet fatura e borxhit të keq janë ato borxhe të konsumatorëve, të cilat plotësojnë kërkesat e borxhit të keq

sikurse janë përshkruar në Nenin 4 të këtij vendimi shpjegues dhe janë regjistruar për qëllime të TVSh-së në Kosovë. Nga KEK-u nuk do të kërkohet të lëshojë fatura të borxhit të keq konsumatorëve shtëpiak apo konsumatorëve tjerë të cilët nuk janë të regjistruar për qëllime të TVSh-së në Kosovë.

Neni 4

4.1 Pavarësisht dispozitave të Nenit 17.1 të Udhëzimit Administrativ 2004/1, për qëllime të këtij vendimi shpjegues publik, borxhi duhet të konsiderohet të jetë borxh i keq kur është më shumë se 6 muaj i vjetër, dhe:

- Vlefshmëria e borxhit nuk është kontestuar juridikisht nga konsumatori.
- TVSh në shumën që korrespondon me borxhin e keq që më herët është përfshirë në detyrimin e TVSh-së së KEK, dhe
- Ka evidencë të duhur të përpjekjeve të arsyeshme të bëra nga KEK për të mbledhur borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen (inkasimin) e borxhit. 'Përpjekjet e arsyeshme' do të përbëjnë secilën prej hapave vijues apo kombinimin e tyre të ndërmarrë nga KEK-u:
 - Thyerjen e çdo borxhi ndaj borxhliut
 - Korrespondenca dhe përpjekjet për kontakt për të inkasuar borxhin, të përbëj lëshimin e njoftimit për çkyqe gjatë periudhës së aplikueshme të borxhit të keq.
 - Veprimi juridik ka qenë i pasuksesshëm. Në lidhje me këtë, KEK kërkohet të lëshojë ndjekje gjyqësore kundër borxheve të konsumatorëve jo-shtëpiak, të cilat janë më shumë se 3,000 euro.
 - Ndjekja gjyqësore është konsideruar të jetë jo-ekonomike për arsye të dokumentuara. Dokumentacioni i tillë dhe arsyet mund të paraqiten çdo 12 muaj.
 - Kërkesën e dorëzuar në një procesin e falimentimit/likuidimit, nëse aplikohet, dhe shuma për t'u marrë është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme nga ekzekutuesi apo administratori
 - Borxhi nuk është i tillë për biznesin e lidhur

4.2 Kur KEK-u të ketë plotësuar kërkesat për deklarimin e borxhit të keq, duhet të ndjekë dispozitat e nenit 17.2 të Udhëzimit Administrativ të ATK-së Nr. 2004/1 mbi Implementimin e Tatimit në Vlerën e Shtuar, në lidhje me lëshimin e një 'fature të borxhit të keq'. Mandej KEK-u ka të drejtë të kërkojë kreditim për borxh të keq në deklaratën e TVSh-së për periudhën në të cilën 'fatura e borxhit të keq' është lëshuar. Përveç që, KEK nuk do të kërkohet të lëshojë fatura të borxhit të keq për konsumatorët shtëpiak apo konsumatorët tjerë të cilët nuk janë të regjistruar për qëllime të TVSh-së në Kosovë.

4.3 Pavarësisht Nenit 22.3 të Ligjit 03/L114, I cili parasheh se, "Shuma e kreditimit tatimor të lejuar sipas këtij neni do të jetë tatimi në vlerën e shtuar i paguar në lidhje me furnizimin që i atribuohet shumës së pakthyer të borxhit të keq," KEK ka të drejtë të kërkojë kreditimin për borxhet e këqija qoftë edhe nëse tatimi për të cilin kreditimi është kërkuar më herët është paguar apo jo.

4.4 Në llogaritjen e shumës së borxhit të keq për qëllime të këtij vendimi shpjegues, KEK do të aplikojë pagesat e pranuar në shumën obligative të faturës për muajin e fundit. Çdo shumë e mbi-paguar e pranuar në çdo periudhë të faturës do të aplikohet në borxhin e tjetër më të fundit të papaguar. Për shembull, fatura e Dhjetorit është lëshuar në Janar. Çdo shumë e pranuar nga KEK-u në mes të datës së lëshimit të faturës së Dhjetorit dhe datës së faturës vijuese (Janar) do të aplikohet në shumën e faturës së Dhjetorit. Çdo shumë e pranuar gjatë kësaj periudhe (para lëshimit të faturës së Janarit) më tepër se shuma e faturës së Dhjetorit do të aplikohet së pari në çdo shumë të pashlyer nga fatura e Nëntorit, mandej në çdo shumë të pashlyer nga fatura e Tetorit e kështu me radhë.

4.5 Për të ndihmuar mundësinë e KEK-ut për të përmbushur kërkesën për të përfshirë numrin identifikues tatimor të tatimpaguesit në faturat e borxhit të keq. ATK do t'i ofrojë KEK-ut një shënim elektronik të të gjithë deklaruesve të regjistruar të TVSh-së, si dhe numrin identifikues të tatimpaguesit për të gjithë bizneset aktive të regjistruara.

4.6 Për shkak të volumit të pritur të faturave të borxhit të keq që do të lëshohen nga KEK, ATK do të ndihmojë KEK-un në vendosjen e një procesi përmes së cilit të dhënat e faturave të borxhit të keq mund të barten në ATK në formatin elektronik.

4.7 Çdo shumë e pranuar nga KEK e aplikueshme në një shumë që më herët është kredituar si një borxh i keq për qëllime të TVSh-së do të përfshihet në deklaratën e TVSh-së së KEK-ut në muajin në të cilin pagesa është pranuar nga KEK-u.

4.8 ATK do të ketë të drejtën të rishikojë raportimin e TVSh-së së KEK-ut në çdo kohë, duke pasuar më njofim të arsyeshëm të synimit për ta bërë.

Neni 5

5.1 Në lidhje me periudhat e tatueshme para 1 Korrikut 2009 (përfshirë vitin 2008) gjatë së cilës KEK-u do të ketë bërë deklaratat e TVSh-së bazuar në shumën e faturuara për konsumatorët, por nuk do t'i ketë paguar në tërësi ato deklarata. Me këtë ATK pajtohet që deklaratat e tilla do të ulen në më të madhen e:

- TVSh-në për pagesë bazuar në shumën e TVSh-së që në të vërtetë është mbledhur nga konsumatorët e KEK-ut; apo
- Shumën e TVSh-së, të cilën KEK-u në të vërtetë ka paguar.

5.2 Tutje, çdo ndëshkim apo interes që do të ketë rrjedhur në lidhje me mos-pagesën e tërësishme të deklaratave KEK-ut, sikurse është përmendur në Nenin 5.1 më sipër, do të ulet në zero. Çdo interes obligativ do të ri-llogaritet për TVSh-në e vlerësuar sipas Nenit 5.1 më sipër.

5.3 Për implementimin e këtij vendim shpjegues publik, KEK do të përdorë një proces që njihet si "Regjistrimi i Përceptimit" përmes së cilit do të raportojë shumën e rrymës së importuar dhe TVSh-në obliguese për atë import, përveç marrjes së kreditimit në deklaratën e TVSh-së. ATK do të vendosë linjat (kutitë) e nevojshme në formën e ndryshuar të deklaratës së TVSh-së për atë qëllim dhe do të informojë KEK-un kur është i gatshëm për përdorim formulari i ndryshuar. Varësisht nga lëshimi i formularit të ndryshuar të TVSh-së, KEK do të vazhdojë të raportojë detyrimin e vet të TVSh-së në mënyrën në të cilën për momentin është duke raportuar TVSh-në.

Neni 6

Ky vendim shpjegues publik është lëshuar në lidhje me KEK-un për të ndihmuar procesin e privatizimit dhe nuk ka aplikim jashtë qëllimit për të cilin është shkruar. Afatet dhe kushtet e vënë në këtë vendim shpjegues nuk do të konsiderohen të jenë procedurale dhe nuk do të citohen si bazë për trajtim të ngjashëm të ndonjë pale tjetër sesa palëve për të cilat është shkruar.

Neni 7

Ky vendim shpjegues aplikohet në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.A. , gjithashtu e njohur si KEK, dhe çdo entitet tjetër i mëvonshëm publik që është i licencuar të kryejë shpërndarjen dhe furnizimin e elektricitetit brenda Kosovës. Tutje, ky vendim shpjegues do të pushojë së aplikuari për KEK-un kur licenca për të kryer shpërndarjen dhe furnizimin e elektricitetit të jetë transferuar tek pasardhësi i KEK-ut.

Neni 8

Ky vendim shpjegues do të përfundojë me datën kur pronësia e Qeverisë së Kosovës mbi aksionet në KEK apo çdo kompani pasardhëse që ka në pronësi asetet e shpërndarjes së elektricitetit, bie nën një qind (100) për qind. Para kësaj datë, KEK-u, apo entiteti i tij pasardhës i shpërndarjes së elektricitetit, duhet të paguajë të gjitha detyrimet e pashlyera të TVSh-së.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave


Z. Ahmet Shala, Ministër

Data:

Gjuha e sugjeruar për 'Fatura e borxhit të keq'

Për: (Emri dhe Adresa e konsumatorit)

Data:

Shuma e borxhit të TVSh:

Numri Serik:

Numri Identifikues i Tatimpaguesit për konsumatorin¹

Numri I faturës që lidhet me Shumën e borxhit të TVSh-së:

1. Shuma e tatueshme mbi faturën e parë
2. Shuma tatimore e korrektuar
3. Obligimi i TVSh-së mbi shumën e tatueshme
4. Obligimi i TVSh-së mbi shumën e tatueshme të korrektuar:
5. Shuma e TVSh-së që duhet ta debitori (3 minus 4):

Me këtë informoheni se një pjesë e borxhit tuaj për furnizim (të elektricitetit) ka qenë e pashlyer për 6 muaj a më shumë. Ligji 03/L-114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar kërkon që ne të ju japim këtë 'faturë të borxhit të keq'. Meqë ju nuk keni paguar ende shumat delikuede të pashlyera dhe nëse ndodh që jeni i regjistruar për qëllime të TVSh-së në Kosovë, ju duhet të debitori në deklaratën tuaj të TVSh-së për shumën e TVSh-së së treguar në këtë faturë. Njoftimi për këtë veprim i është dhënë administratës tatimore për informatë në zbatimin e ligjeve të TVSh-së së Kosovës. Ata mund të përcaktojnë se shumat shtesë duhet të debitorohen bazuar në mos-pagesën e faturave tjera të pashlyera për periudhat e mëhershme në periudhat e mbuluara me këtë faturë. Nëse më vonë bëni pagesë të shumës së pashlyer, ju mund të kërkonti kreditimin e zbritshëm në deklaratën e TVSh-së e dorëzuar për periudhën në të cilën keni bërë pagesën. Shuma e kreditimit që do të kërkohet është e kufizuar në shumën të cilën e kanë debituar më herët dhe tash keni të drejtë ta merrni si kreditim i zbritshëm.

Lëshimi I kësaj fature në asnjë mënyrë nuk kufizon mundësinë e KEK-ut të kërkojë të gjitha mjetet juridike për të inkasuar çdo balancë të pa shlyer e cila është obligim. Sikurse jeni informuar më herët, KEK-u synon të kërkojë ndihmë juridike për të inkasuar borxhin tuaj. Përveç kësaj, KEK-u mund të ndërmarrë aksione të çkyqjes për të detyruar pagesën ashtu siç është e autorizuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

¹ Dihet se deri sa regjistrimet e ATK dhe KEK të barazohen në tërësi, Nr. Identifikues i Tatimpaguesit për konsumatorin mund të harrohet nga fatura e Borxhit të Keq



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/60

Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 32 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37 dhe Udhëzimit Administrativ, Përbërja dhe Kompetencat e Komisionit të Gjuhëve, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Emërohen anëtarët e komisionit për përdorimin e gjuhëve në këtë përbërje:
 - a) Fehmi Stublla - Zyra Kryeministrit (kryesues)
 - b) Fadil Bytyçi - Kuvendi i Kosovës
 - c) Bedri Bahtiri - Ministria e Drejtësisë
 - d) Selami Osmani - Ministria e Shërbimeve Publike
 - e) Dragana Zhivković - Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve
 - f) Nazan Safçi - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 - g) Fitim Tahiri - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjithë sekretarët e përhershëm të ministrive përkatëse, të përfaqësuara në këtë komision.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/60
Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 35.276 (tridhjetë e pesëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Euro për organizimin e kremtimeve me rastin e festës së 23 prillit, ditës së turqve.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga "Rezervat e Paparashikuara" të Qeverisë dhe barten në xhirollogarinë e shoqatës Multiethnic Society of Kosovo, Nr. 1502031000679574 - Raiffeisen Bank, me numër regjistrimi 5110708.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/60

Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 8.4 dhe 10 Ligjit mbi Dokumentet e Udhëtimit, Vendimin e Qeverisë Nr. 02/31, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

PËR PLOTËSIM - NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 02/31 PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE ZYRTARE

1. Paragrafi 3.1 i vendimit Nr. 02/31 plotësohet si vijon:
 - 1.1 Listës së kategorisë së pozitive, që pajisen me pasaportë diplomatike, të përcaktuar në paragrafin 3.1 të këtij vendimi i shtohet edhe Shefi i Agjencisë së Inteligjencës
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/60

Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Të iniciohet procedura për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit.
2. Bartëse e këtij procesi caktohet Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Haslum THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/60


Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për hartimin e dokumentit përmbajtësor të Projektligjit për Emërtimin e Komunave dhe Fshatrave të Republikës së Kosovës.
2. Grupi punues do të përbëhet nga përfaqësues të këtyre institucioneve:
 - 2.1 Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal - kryesues;
 - 2.2 Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Republikës së Kosovës - anëtar;
 - 2.3 Agjensioni i Arkivave të Kosovës - anëtar;
 - 2.4 Instituti Albanologjik - anëtar;
 - 2.5 Agjencioni Kadastral - anëtar;
 - 2.6 Instituti i Historisë - anëtar;
 - 2.7 Enti i Statistikave të Kosovës - anëtar;
 - 2.8 Ministria e Ekonomisë dhe Financave - anëtar;
 - 2.9 Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
 - 2.10 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve - anëtar;
 - 2.11 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - anëtar;
 - 2.12 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - anëtar;
 - 2.13 Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve - anëtar, dhe
 - 2.14 Asociacioni i Komunave të Kosovës - anëtar

3. Kompensimin e përfaqësuesve të jashtëm në këtë grup punues e bënë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 08/60

Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës, si dhe agjencitë dhe organet tjera të përfshira në këtë Strategji.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/60
Datë: 08.04.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë